



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE
Drejtoria e Administrimit te Prones Publike

URDHER

Nr. 297 Date 11.8.2003

PER

ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE SH.P.K. "UZINA MEKANIKE
E NAFTES" KUÇOVE ME PERFSHIRJEN E REZERVAVE

Drejtuar: Sh.p.k. "Uzina Mekanike e Naftes" Kuçove

Ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996, Ligjit Nr. 8885 date 22.04.2002 dhe neni 56, te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", me cilesine e ortakut te vetem ,

URDHEROJ:

Ne aktet e themelimit te Sh.p.k "Uzina Mekanike e Naftes" Kuçove te behen ndryshimet e meposhteme:

1. Kapitali Themeltar te zmadhohet, me **perفشirjen e rezervave, per vleren 53 950 000 leke**, e barabarte me 53 950 pjese me vlere nominale 1000 leke per pjese.
2. Kapitali Themeltar i Sh.p.k "Uzina Mekanike e Naftes" Kuçove, te behet 54 450 000 leke i barabarte me 54 450 pjese me vlere nominale 1000 leke secila. Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.
3. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit te Prones Publike per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare". Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

Arben MALAJ

MINISTER





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE
Drejtoria e Administrimit te Prones Publike

URDHER
Nr 302 Date 8.1.2004

PER
ZMADHIMIN E KAPITALIT TE SH.P.K. "UZINA MEKANIKE E NAFTAES"
KUÇOVE

Drejtuar: Sh.p.k "Uzina Mekanike e Naftes" Kuçove


Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996, Ligjit Nr. 8885 date 22.04.2002 dhe Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare, neni 63, VKM Nr.139, date 13.03.2003 "Per kriteret dhe procedurat e vleresimit dhe shitjes se trojeve, me cilesine e ortakut te vetem ,

URDHEROJ:

Ne aktet e themelimit te Sh.p.k. "Uzina Mekanike e Naftes" Kuçove, te behen ndryshimet e meposhteme:

1. Kapitali Themeltar te zmadhohet, me rivleresimin e truallit, per vleren 89.392.290 leke, c barabarte me 89.392 pjese me vlere nominale 1000 leke secila.
2. Kapitali Themeltar i Sh.p.k. "Transnafta" Patos, te behet 143.842.290 leke e barabarte me 143.842.2 pjese me vlere nominale 1000 leke secila.
Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.
3. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit te Prones Publike si dhe Drejtoria Sh.p.k. "Uzina Mekanike e Naftes" Kuçove, per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te ligjit Nr.7667, date 28.11.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare".
4. Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

Anastas ANGJELI
MINISTER





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË**

Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve dhe Shoqërive të Vogla dhe të Mesme ✓

URDHER
Nr. 156 Date 16.5, 2003

PER

**VLERESIMIN E TRUALLIT TE SHOQERISE ANONIME "UZINA MEKANIKE
E NAFTAES" SH.PK. KUÇOVE**

Drejtuar: Shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes" Sh.p.k.Kuçove

Duke marre parasysh kërkesat ligjore dhe proceduriale te vleresimit te elementeve te pasurise se shoqerise, ne zbatim te vendimit nr.169, date 13.03.2003 te Keshillit te Ministrave,

KONSTATOVA

Se ne mbeshtetje te nenit 1 te Ligjit Nr. 8885, date 22.04 2002 "Per disa ndryshime ne ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare, ndryshuar me akte te tjera ligjore"; Ligjit Nr 7638 date 19.11 1992 "Per shoqerite tregtare"; ne zbatim te Vendimit Nr.169, date 13.03.2003 te Keshillit te Ministrave "Per kriteret dhe procedurat e vleresimit dhe te shitjes se trojeve te ndermarrjeve shteterore qe u nenshtrohen privatizimit apo transformimit te tyre ne shoqeri tregtare" dhe Vendimit Nr.119 date 27.02.2002 te Keshillit te Ministrave" Pika 7, paragrafi i pare, duhet te behet vleresimi i truallit te shoqerise.
Persa me siper, ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise, me cilesine e zoteruesit te aksioneve te shoqerise,

URDHEROJ :

1. Te vleresohet trualli i shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes" Sh.p.k.Kuçove ne zbatim te Vendimit Nr.169, date 13.03.2003 te Keshillit te Ministrave.
2. Z.Namik Veipi, ekspert kontabel i autorizuar te pergatise raportin e zmadhimit te kapitalit ne perputhje me piken 1 te ketij urdheri .
3. Ngarkohet drejtoria e shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes " Sh.p.k.Kuçove per zbatim.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.



Arben MALAJ
[Signature]
MINISTER

**RAPORT I VECANTE I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR MBI
ZMADHIMIN E KAPITALIT TE "UZINA MEKANIKE E NAFTAES" sh.p.k. KUCOVE**

Me cilesine time si ekspert kontabel I autorizuar ,sipas kerkeses se ligjit Nr.7638 dt. 19/11/1992 " Per Shoqerite Tregetare" po ju paraqes raportin e vecante per zmadhimin e kapitalit ,si rezultat I rivleresimit te truallit te shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes " sh.p.k. Kucove, ne zbatim te vendimit Nr. 169 dt.13.03. 2003 te Keshillit te Ministrave dhe urdhrit nr. 156 date 16 .05 .2003 te Ministrise se Ekonomise.

Per kryerjen e ketij misioni nga ana ime eshte proceduar sipas V.K.M. dhe udhezimit te dale per rivleresimin e truallit ,duke filluar nga krijimi I komisioneve deri ne miratimin e cmimit mesatar te truallit dhe ne evidentimin e sakte te siperfaqeve .

Projekti I zmadhimit te kapitalit te llogaritur nga ana ime ,evidenton operacionin e zmadhimit te kapitalit si rezultat I rivleresimit te trojeve te shoqerise qe sipas aktit te vleresimit te leshuar nga ana e Seksionit te Finances te Bashkise Kucove me nr. 502 prot. Dt.26.05.2004 te konfirmuar nga Urbanistika ,rezulton :

-Qendra e shoqerise U.M. N Kucove	Sip. 96 568 m ²	Vlera 77 254 640 leke
-Uzina e Tynelizuar	Sip. 17 243 m ²	Vlera 11 057 650 "
-Sektori Oksigjenit	Sip. 1 200 m ²	Vlera 960 000 "
-Sektori Pompa	Sip. 150 m ²	Vlera 120 000 "
SHUMA	115 161 m²	Vlera 89 392 290 leke

Ne bilancin e ekspertuar te vitit 2004 vlera e truallit te shoqerise rregjistrohet per shumen lek 91 560 000 lek, keshtu qe diferenca prej 2 167 710 leke perbene shumen e zvogelimit te vleres se tokes se shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes " sh.p.k. Kucove ,nga vleresimi I sakte I truallit te bere ,sipas V.K.M. Nr. 169 dt.13.03.2003" Per kriteret e vleresimit te prones shteterore"

Ne se operacioni I zmadhimit te kapitalit realizohet sipas projektit te paraqitur nga ana ime , atehere:

-Kapitali I sh.p.k. " Uzina Mekanike e Naftes " sh.p.k. Kucove nga vlera per 54 450 000 leke para operacionit te ndare ne 54 450 pjese te barabarta ,me vlera nominale 1 000 leke seicili , do te zmadhohet per 89 392 290 leke ,duke mbritur

pas operacionit ne vleren 143 842 290 leke duke e lene vleren e nje pjese 1000 leke ,do te formohen 143 842 pjese.

Per zmadhimin e kapitalit te shoqerise sipas urdhrin nr.156 dt. 16.05.2003 te Ministrit te Ekonomise ,kapitali I ri I sjhoqerise rezulton 143 842 290 leke , ndryshimi qe duhet te pasqyrohet ne regjistrin tregetar te Gjykates Tirane.

Kapitali I Shoqerise ishte 54 450 000 leke ,behet 143 842 290 leke.


Rekomandojme qe zmadhimi i kapitalit te shoqerise me ndryshimet perkatese te pasqyrohet dhe ne statusin e shoqerise .

Bashkangjitur ketij raporti te vecante ,eshte dhe nje kopje e bilancit te shoqerise "Uzina Mekanike Naftes " sh.p.k. Kucove te 6- mujorit te vitit 2004 , me ndryshimet perkatese te bera pas operacionit te zmadhimit te kapitalit.

Kucove dt. 30.06.2004

Eksperti Kontabel I Autorizuar
Namik Vehipi

NAFTES
ESPAT
LIC. NO. 100
MINISTRIA E FINANCES
VLORA - ALB. 119
PAMVARSIA 119
TEL. 063-22889





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË

Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve dhe Shoqërive të Vogla e të Mesme

URDHER

Nr. 90, Date 12.04.2005

PER

ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE
“UZINA MEKANIKE E NAFTAES” SH.P.K. KUCOVE

Drejtuar: Shoqerise “Uzina Mekanike e Naftes” Sh.p.k. Kucove

Ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 e Kushtetutes te Republikes se Shqiperise, te nenit 2 te Ligjit nr. 8237, date 01.09.1997 “Per disa ndryshime ne Ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 “Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare”, ndryshuar me akte te tjera ligjore, Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002, nenit 150 te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”, me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise,

URDHEROJ:

1. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise “Uzina Mekanike e Naftes” Sh.p.k. Kucove, per vleren e asetëve te shkeputura nga shoqeria “Servcom” Sh.a Fier ne masen 123,673,000 leke e barabarte me 123,673 pjese me vlere nominale 1,000 leke secila.
2. Kapitali i shoqerise “Uzina Mekanike e Naftes” Sh.p.k. Kucove behet 267,515,290 leke, i barabarte me 267,515 pjese me vlere nominale 1,000 leke secila.
3. Ngarkohet Drejtoria e shoqerise “Uzina Mekanike e Naftes” Sh.p.k. Kucove, per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 “Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare”.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.



Raport

Per zmadhimin e Kapitalit Themeltar te Sh.p.k. "Uzina Mekanike e Naftes" Kucove,per vleren e aseteve te shkeputura nga Sh.a "Servcom "Fier

Sipas Urdherit nr. 66 date 15.03.2005 te Ministrit te Ekonomise,Kapitali Themeltar I Sh.p.k. "Uzina Mekanike e Naftes " Kucove , zmadhohet per vleren e aseteve te shkeputura nga Sh.a "Servcom " Fier ose te shprehur me qarte zmadhimi do te behet per vleren e aktiveve neto sipas bilancit te ndarjes se sh.p.k "Uzina Mekanike e Naftes " Kucove nga Sh.a "Servcom" Fier me dt. 30.06.2000.

Ne zbatim te urdhit nr.66 date 15.03.2005 te Ministrit te Ekonomise ,sh.p.k. "Uzina Mekanike e Naftes " procedoi si me poshte :

-Per te kryer zmadhimin e Kapitalit per asetet e shkeputura nga sh.a "Servcom " Fier u bazua ne bilancin e perpiluar ne dt. 30.06.2000

-Nga bilanci i dt. 30.06.2000 u percaktuan inventaret kontabel te kerkesave debitore dhe detyrimeve

Ne caktimin e vleres se aktiveve neto qe do te sherbejne per zmadhimin e kapitalit themeltar te sh.p.k. "Uzina Mekanike e Naftes " Kucove propozojme te merren ne Konsiderate:

-Mosperfshirja ne zmadhimin e kapitalit te diferencave te rivleresimit te aktiveve te qendrushme te trupezuara te kryera ne vitin 1998 ne shumen 38 837 323 lek

-Mosperfshirja ne zmadhimin e kapitalit te primit te ndarjes se caktuar ne vitin 1998 ne bilancin e shoqerise Sh.a "Servcom " Fier per llogari te sh.p.k. "Uzina Mekanike e Naftes" Kucove ne vleren 7 323 570 lek.

Persa i perket dy vlerave te mesiperme ,ato jane perfshire ne zmadhimin e Kapitalit te Shoqerise "U.M.N. " sh.p.k. Kucove ,sipas Vendimit Nr. 24127 /1 i aktit date 26.05.2004 te Gjykates se Shkalles se Pare ,Tirane.

-Mosperfshirja ne zmadhimin e Kapitalit te elementeve te pasurise qe nuk kane vlere perdorimi ne shumen 23 072 356 leke.

Ne kete menyre ,projekti qe po japim per zmadhimin e kapitalit per vleren e aktiveve neto , gjithmone duke l'u referuar bilancit ne daten 30.06.2000 konsiston ne keto te dhena :

1.Aktivi I bilancit ne dt. 30.06.2000	230 884 585 lek
2-Detyrimet e kerkueshme deri ne 30.06.2000	37 978 336 lek
3-Aktivet Neto (1-2) ne dt. 30.06.2000	192 906 249 lek

Nga shuma 3 zbriten.:

a-Diferencat e rivleresimit	38 837 323 lek
b-Prime te lidhura me kapitalin	7 323 570 lek
c-Elemente te pasurise pa vlere perdorimi	23 072 356 lek
Shuma e vlerave te paperfshira ne aktivat neto (a+b+c)	69 233 249 lek


4-Shuma projekt per zmadhimin e kapitalit per asetet e shkeputura nga Servcom sh.a Fier 3-(a+b+c)=192 906 249lek-69 233 249lek	123 673 000 lek
--	-----------------


Ne vleren e aktivit neto 123 673 000 leke nuk perfshihet vlere e truallit ,e cila ne momentin e ndarjes se Uzines Mekanike Naftes sh.p.k. Kucove ,nga sh.a "Servcom" Fier, nuk ka qene e vleresuar dhe per rrjedhim as e perfshire ne bilanc .
Veprimet per vleresimin e marrjen ne pronesi te truallit jane bere pas ndarjes nga sh.a "Servcom " Fier.Ato tashme kane gjetur shprehjen e vete ne kapital me Vendimin Nr.24127/2 date 15 10.2004 te Gjykates se shkalles se pare Tirane per zmadhimin e kapitalit te Shoqerise me vleren e truallit 89392 290 leke.

-Per sa me siper propozimi yne per zmadhimin e kapitalit te shoqerise parashikon krijimin e 123 673 pjeseve te reja me vlere nominale te njejte me pjeset ekzistuese , 1 000 leke seicila .

-Me miratimin e ketij propozimi,Kapitali i sh.p.k. "Uzina Mekanike e Naftes" Kucove do te zmadhohet per 123 673 000 leke dhe do te arrije vleren 267 515 290 leke , nga 143 842 290 leke qe eshte aktualisht.

-Numri i pjeseve te kapitalit nga 143 842 pjese qe eshte para ketij zmadhimi, do te shtohet me 123 673 pjese ,duke arritur pas zmadhimit ne 267 515 pjese te barabarta me vlere nominale 1 000 leke seicila.




REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGETARE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE

URDHER

Nr. 476 Date 28.6.2006

PER

**ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE SH.P.K "UZINA MEKANIKE E NAFTAES"
KUÇOVE**

Drejtuar: SH.P.K "UZINA MEKANIKE E NAFTAES" KUÇOVE

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise, te Ligjit Nr.8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndërmarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr.8099, date 28.03.1996, Dekretin nr.1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin nr.8158, date 07.11.1996, Ligjit nr.8885 date 22.04.2002 dhe Ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", me cilesine e aksionarit te vetem ,

URDHEROJ :

1. Kapitali Themeltar te zvogelohet per vleren 2 953 808 leke, e barabarte me 2.953.8 pjese, me vlere nominale 1000 leke secila.
2. Kapitali themeltar i sh.a "Uzina Mekanike e Naftes" Kuçove, behet 264 561 482 leke, i barabarte me 264 561.4 pjese me vlere nominale 1000 leke secila. Keto ndryshime te behen ne aktet e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.
3. Ngarkohet Drejtoria e Shoqerise per kryerjen e veprimeve perkatese ne përputhje me parashikimet e nenit 33 te ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

Ky urdhër hyn ne fuqi menjehere.



MINISTRI

GENORULI

Adresa: Blvd. "Deshmoret e Kombit" Nr.2
E-mail: Kabinet@mete.gov.al
Internet: <http://www.mete.gov.al>

Tel: +355 4 226241
Tel: +355 4 223158
Fax: +355 4 234052

RAPORT

Per zvogelimin e Kapitalit Themeltar te Sh.p.k "Uzina Mekanike e Naftes" Kucove per fondin e banesave ne pronesi te "U.M.N." Sh.p.k. Kucove qe jane ne perdorim nga ish punonjesit e saj .

Sipas Urdherit nr. 48/1 date 21.03.2005 te Ministrit te Ekonomise ,Kapitali Themeltar i sh.p.k. "Uzina Mekanike e Naftes" Kucove ,zvogelohet per vleren e aseteteve qe i perkasin Fondit te Banesave ne pronesi te "U.M.N.",Sh.p.k. Kucove qe jane ne perdorim nga ish punonjesit e saj.

Ne zbatim te Urdherit nr 48/1 Date 21.03.2005 te Ministrit te Ekonomise ,Sh.p.k. "Uzina Mekanike e Naftes" Kucove procedoi si me poshte :

-Per te kryer zvogelimin e Kapitalit Themeltar per Fondin e Banesave ne pronesi te "U.M.N" sh.p.k. Kucove qe jane ne perdorim nga ish-punonjesit e saj ,shoqeria jone u bazua ne bilancin e perpiluar ne daten 31.03.2005.

-Nga bilanci i periudhes deri ne 31.03.2005 u percaktuan dhe u rakorduan inventaret kontabel te Fondit te Banesave ne perdorim te ish-punonjesve te Sh.p.k. "U.M.N" Kucove .Per kete u hartuan inventaret kontabel per truallin,ndertesat si dhe amortizimi i akumuluar dhe vlera e mbetur e ndertesave sipas pasqyrave te paraqitura me poshte nepermjet te cilave do te vleresojme vleren e aseteteve qe i shkeputen shoqerise "U.M.N. " Sh.p.k. Kucove dhe te cilat kalojne ne dispozicion te Entit Kombetar te Banesave :

*Inventari i ndertesave ne perdorim te punonjesve qe i kalojne Entit Kombetar te Banesave per privatizim

Mihal ZIU
Ekspert Kontabël i Autorizuar
Liçensa Nr 62, datë 10.02.2000

RAPORT

Për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë “Uzina Mekanike e Naftës” Sh.p.k. Kuçovë

Në zbatim të urdhërit të Ministrit të Ekonomisë Nr 48/1 datë 21.03.2005 për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë “Uzina Mekanike e Naftës” Sh.p.k. Kuçovë me fondin e banesave në pronësi të UMN Sh.p.k. Kuçovë, që janë në përdorim nga punonjës e ish-punonjës të saj, në cilësinë e ekspertit kontabël të autorizuar, paraqes këtë raport mbi zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë “Uzina Mekanike e Naftës” Sh.p.k. Kuçovë, si më poshtë vijon:

Kam verifikuar projektin e zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë “Uzina Mekanike e Naftës Sh.p.k. Kuçovë, të paraqitur në raportin e Administratorit të Përgjithshëm, duke audituar informacionet e dhëna në të dhe informacionet e tjera që lidhen me këtë operacion të zvogëlimit të kapitalit, që unë i kam çmuar të nevojshme për mbështetjen e opinionit tim si ekspert kontabël i autorizuar.

Gjatë verifikimit jam përqendruar në motivet e këtij zvogëlimi të kapitalit, në plotësimin e modaliteteve të nevojshme për këtë operacion dhe në saktësinë e projektit të propozuar nga Drejtoria për zvogëlimin e kapitalit.

Për sa më sipër, gjatë verifikimit konstatova dhe formova opinionin se :

-Shoqëria “Uzina Mekanike e Naftës” Sh.p.k. Kuçovë ka në përbërje të kapitalit të vet vlerën e disa objekteve të kthyera në banesa për punonjës dhe ish-punonjës të saj, të cilat nuk i shërbejnë më aktivitetit të saj tregtar. Sipas inventarit këto objekte identifikohen si më poshtë:



Nr.	Emertimi	Viti i venies ne shfrytezim	Vlefta fillestare në lekë	Siperfaqja e truallit ne m2	Siperfaqja nen objekt ne m2	Numri i pasurise
1	Fjetore e punëtorve dhe menca (Tunel)	1978	2.267.593	730	373.8	5/300
2	Dhoma higjenike(Tunel)	1978	259.200	730	162.7	5/301
3	Godina e rojeve(Tunel)	1978	34.605	250	19.6	5/302
4	Magazina Rikupero	1962	843.944	995	48	9/449
5	Stacioni pompimit	1986	603.925	150	51.8	4/55
	Shuma		4.009.267	2855	655.9	

- Bazuar në VKM Nr 470 datë 31.8.2000 dhe në Urdhërin e Ministrit të Ekonomisë Nr 48 datë 27.08.2005 dhe Nr 48/1 datë 21.3.2005 Shoqëria "Uzina Mekanike" Sh.p.k Kuçovë ka përgatitur projektin e zvogëlimit të kapitalit, i cili prezantohet në Raportin e Administratorit të Përgjithshëm më 4.04.2005. Këtij projekti me vone shoqëria i ka bërë ndryshime, duke zvogëluar sipërfaqen e truallit të pasurisë Nr. 9/449 nga 1480 m2 në 995 m2.

Ndërmarrja e këtij projekti zvogëlimi, Shoqërisë i shkëput nga zotërimi pasuri të përfshira në kapitalin themeltar të saj, prandaj operacioni i zvogëlimit të kapitalit është i motivuar nga dalja e aktiveve dhe i bazuar në nenet 64; 164 të Ligjit Nr 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqërite Tregtare"

- Shuma e zvogëlimit të kapitalit e paraqitur në raportin e Administratorit të Përgjithshëm është 2.953.808 lekë dhe përbëhet nga vlera neto e ndërtesave që i kalojnë Entit Kombëtar të Banesave dhe nga vlera e truallit të këtyre ndërtesave.

Sipas këtij projekti të paraqitur nga Drejtimi i Shoqërisë, shuma e zvogëlimit të kapitalit në lekë rezulton si më poshtë:

	Vleftë Fillestare	Amortizimi	Vlera neto
1. Ndërtesat			
-Fjetore dhe mencë puntorësh	2.267.593	1.748.314	519.279
- Dhoma higjenike	259.200	199.843	59.357
- Godina e rojeve	34.605	29.680	4.925
- Magazina rikupero	843.944	843.944	0
Stacioni i pompimit	603.925	335.178	<u>268.747</u>
Shuma për zvogëlimin e kapitalit			852.308

2. <u>Trualli</u>	Sipërfaqja totale e truallit në m2	Çmimi i truallit për 1 m2	Vlefta
- Fjetore dhe menca	730	800	584.000
- Dhoma higjenike	730	550	401.500
- Godina e rojeve	250	800	200.000
- Magazina rikupero	995	800	796.000
- Stacioni i pompimit	150	800	<u>120.000</u>
Shuma e llogaritur për Zvogëlimin e kapitalit			2.101.500

3. Totali i shumës së zvogëlimit të kapitalit sipas shoqërisë:

- Nga ndërtesat	852.308 lekë
- Nga trualli	<u>2.101.500</u> lekë
Gjithsej zvogëlimi i kapitalit	2.953.808 lekë

Gjithsej zvogëlimi i kapitalit sipas projektit të shoqërisë 2.953.808 lekë ose 2.954 pjesë me vlerë nominale 1.000 lekë secila .

Sipas këtij projekti, kapitali themeltar i shoqërisë nga 267.515.290 lekë që është aktualisht do të zvogëlohet 2.953.808 lekë dhe do të arrijë në vlerën 264.561.482 lekë, kurse numri i pjesëve të kapitalit nga 267.515 pjesë do të zvogëlohet 2.954 pjesë dhe do të arrijë në 264.561 pjesë me vlerë të barabartë 1.000 lekë secila.

- Metodika dhe procedura e ndjekur nga Uzina Mekanike e Naftës Sh.p.k Kuçovë për përcaktimin e vlerës neto të ndërtesave që kalojnë në privatizim punonjësve të saj është në pajtim me normat e kontabilitetit, sipas të cilit vlera neto e aktivitetit është e barabartë me vleftën fillestare paksuar me amortizimin e akumuluar . Sipas kësaj praktike të mbeshtetur në

ligjin Nr 7661 datë 19.1.1993 "Për kontabilitetin" dhe me VKM Nr 334 datë 9.7.1993, Shoqëria ka përcaktuar drejt vlerën neto të ndërtesave që i kalojnë Entit Kombëtar të Banesave në shumën 852.308 lekë .

Elementi i dytë i llogaritur në zvogëlimin të kapitalit është vlera e truallit të ndërtesave . Proçedura e ndjekur për përcaktimin e saj është e drejtë .Kjo vlerë rezulton si produkt i sipërfaqeve të truallit të ndërtesave me çmimin për 1 m² .

Çmimi i përdorur për vlersimin e truallit është korrekt dhe i konfirmuar nga Bashkia Kuçovë , sipas vendodhjes, kurse sipërfaqja e truallit është e përcaktuar në mënyrë evazive, pa një referencë ligjore, se cila sipërfaqe duhet të përfshihet në projektin zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë "Uzina Mekanike" Sh.p.k. Kuçovë . Drejtimi i shoqërisë ka operuar me sipërfaqen totale, që figuron në inventar të secilit objekt ndërtimor, që do të privatizohet si fond banese. Por vendosim në vëmendjen tuaj se sipërfaqja totale e truallit të këtyre banesave është shumë më e madhe se sipërfaqja nën objekt . Në total kjo diferencë paraqitet si vijon:

Sipërfaqe totale e truallit	2.855 m ²
Sipërfaqe nën objekt	<u>656 m²</u>
Diferenca	2.199 m ²

Përfshirja në projektin e zvogëlimit të kapitalit të diferencës së mësipërme të truallit nuk është e referuar në ligj.

Raporti midis sipërfaqjes totale të truallit dhe sipërfaqjes nën objekt të banesës që privatizohet për objekte të veçanta varion nga 1,95 në objektin "Fjetore dhe menca" (me numër pasurie 5/300) në 20,73 në objektin "Magazina Rikupero"(me numër pasurie 9/449).

Natyrisht këto diferenca midis sipërfaqes totale të truallit të përfshirë në projektin e zvogëlimit të kapitalit dhe sipërfaqes nën objekt të banesave që privatizohen e bëjnë të diskutueshëm saktësinë e projektit të zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë "Uzina Mekanike e Naftës" Sh.p.k. Kuçovë. Prandaj mendoj se është e nevojshme rishikimi i tij, për të përfshirë në projektin e zvogëlimit të kapitalit vetëm sipërfaqen e domosdoshme funksionale të truallit të banesave që privatizohen. Një kërkesë e tillë është bërë edhe nga Ministria e Ekonomisë me shkresën Nr.3258, date 24.05.2005.

Si përfundim, mbështetur në verifikimet e kryera dhe duke iu përmbajtur konstatimeve të mësipërme shpreh opinionin se:

a) Vendimi i marrë nga Shoqëria "Uzina Mekanike e Naftës" Sh.p.k Kuçovë për zvogëlimin e kapitalit themeltar për vlerën e fondit të banesave që do të privatizohen në favor të punonjësve që banojnë në to është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

b) Sipas këtij projekti, të përgatitur nga Drejtimi i Shoqërisë shuma e zvogëlimit të kapitalit është 2.953.808 lekë dhe numri i pjesëve që zvogëlohen është 2.954 pjesë me vlerë nominale 1.000 lekeë secila. Në rast se ky projekt miratohet Kapitali Themeltar i Shoqërisë nga 267.515.290 lekë do të arrijë në vlerën 264.561.482 lekë dhe numri i pjesëve të kapitalit nga 267.515 pjesë do të arrijë në 264.561 pjesë me vlerë nominale 1.000 lekë secila.

c) Shoqëria ka kryer veprimet konkrete për zbatimin e këtij projekti, por Ministria e Ekonomisë me shkresën Nr. 3258/2 datë 11.07.2005 ka kërkuar anulimin e veprimeve të kryera lidhur me truallin e objekteve, që kanë kaluar fond banesash. Kjo kërkesë kontestohet nga Bashkia Kuçovë dhe Uzina Mekanike sh.p.k. Kuçovë

ç) Mbështetur në verifikimet e kryera gjatë auditimit dhe duke i përmbajtur konstatimeve të paraqitura në këtë raport shpreh rezervën time për saktësinë e shumës së zvogëlimit të kapitalit. Kjo rezervë buron nga përfshirja e pa argumentuar në projektin e zvogëlimit të kapitalit të një sipërfaqeje trualli shumë më të madhe në krahasim me sipërfaqen nën objekt për banesat që do të privatizohen.

Mihal ZIU



Kuçovë, 29.7.2005

Ekspert Kontabël i Autorizuar

Dr. MIHAL ZIU
Ekspert Kontabël
Rr. M. Shyti 1.4413 Kuv. 1
TIRANË



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE

URDHER

Nr. 46 Date 27/01/2010

PER

ZMADHIMIN E KAPITALIT TE SH.P.K "UZINA MEKANIKE E NAFTAES" KUÇOVE

Drejtuar: SH.P.K "Uzina Mekanike e Naftes" Kuçove ✓

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndemarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, dhe Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", me cilesine e ortakut te vetem te Sh.p.k "Uzina Mekanike e Naftes" Kuçove,

URDHEROJ:

- 1 Kapitali Themeltar te zmadhohet per vleren 153 569 870 leke , i barabarte me 153 569 aksione me vlere nominale 1000 leke secila.
- 2 Kapitali Themeltar i shoqerise behet 418 131 000 leke, i barabarte me 418 131 aksione me vlere nominale 1000 leke secila.
- 3 Keto ndryshime te behen ne aktet e themelimit te shoqerise.
- 4 Bazuar ne Ligjin 9723, date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqerise " Uzina Mekanike e Naftes" Kuçove per kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet perkatese ne rregjister.

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.

MINISTRI


DRITAN PRIFTI



**RAPORT I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR
PER KONTROLLIN E OPERACIONEVE TE KRYERA PER ZMADHIMIN
E KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE
"UZINA MEKANIKE E NAFTAES" SH.P.K. KUÇOVE**

Me cilesine e Ekspertit Kontabel te Autorizuar jam caktuar me shkresen Nr.3422/1, date 16.07.2009 te Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes "Per pergatitjen e raportit per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise Uzina Mekanike e Naftes sh.p.k. Kuçove per vleren e rivleresuar te truallit sipas VKM nr. 1620 date 26.11.2008.

Shoqeria "Uzina Mekanike e Naftes" sh.p.k. Kuçove eshte e rregjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane Nr. 24127, date 06.07.2000. Selia e shoqerise eshte ne Kuçove.

Organet drejtuese jane:

- Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes Tirane.
- Administratori i pergjithshem eshte z. Fatos Dardha.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte : Kryerja e te gjitha punimeve mekanike per industrine e naftes si edhe çdo lloj punimi e sherbimi per te tretet. Shoqeria do te zhvilloje edhe çdo aktivitet tjeter te mundshem ne interes e shoqerise e ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Kapitali i shoqerise eshte 264.561.482 leke i ndare ne 264.561 pjese te barabarta me vleren nominale 1.000 leke secila. Kapitali eshte teresisht prone shtetore dhe te gjitha pjeset e tij zoterohen nga shteti shqiptar.

Kapitali i shoqerise sipas ekstraktit te regjistrimit tregtar per te dhenat e subjektit eshte 500.000 leke i ndare ne 500 pjese me vleren nominale 1.000 leke secila, pra shoqeria nuk ka bere azhornimin e ndryshimeve te ndodhura ne Regjistrin Tregtar per te cilen duhet vepruar menjehere.

Baza ligjore .

Ligji 9901 date 14.04.2008 " Per Shoqerite Tregtare", neni 81 dhe Standarti Kombetar i Kontabilitetit nr.5 "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale".

Dokumentacioni i shoqerise :

1. Akt themelimi, Statuti, Vendimi i Gjykates Nr.24127, date 06.07.2000,
2. Bilancin kontabel dhe pasqyrat financiare te vitit 2008 te audituar nga ekspertet kontabel te autorizuar, shoqeruar me inventaret per çdo post te bilancit, certifikatat e regjistrimit te

[Signature]

pasurise ne Zyrat e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme e dokumenta te tjera te nevojshme.

Qellimi i zmadhimit

Kapitali i shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes" sh.p.k. Kuçove ne momentin e marrjes se misionit eshte 264.561.482 leke i ndare ne 264.561 pjese me vleren nominale 1.000 leke secila, zoterues i te cilave eshte shteti shqiptar.

Kapitali i shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes" sh.p.k. Kuçove do te zmadhohet per vleren e vleren e rivleresuar te truallit ne mbeshtetje te VKM nr.1620, date 26.11.2008.

Si pikenisje per percaktimin e vleres se kapitalit u mor bilanci dhe pasqyrat financiare te shoqerise ne date 31.12.2008 si edhe u analizuan te gjitha trojet e shoqerise te cilat paraqiten :

Te dhena per siperfaqet	m2	vlera para rivleresimit	vlera pas rivleresimit	Diferencat pozitive
Pasuria nr 9/485 ne Zonen Kadastrale 2310	92646.1	74116880	203821420	129704540
Pasuria nr 9/483 ne Zonen Kadastrale 2310	1103.9	883120	2428580	1545460
Pasuria nr 9/482 ne Zonen Kadastrale 2310	479.5	383600	1054900	671300
Pasuria nr 9/484 ne Zonen Kadastrale 2310	1343.8	1075040	2956360	1881320
Pasuria nr 11/558 ne Zonen Kadastrale 2310	1200	960000	2640000	1680000
Pasuria nr 5/303 ne Zonen Kadastrale 2310	15533	9872150	27959400	18087250
Totali	112306.3	87290790	240860660	153569870

Shuma e zmadhimit te kapitalit te shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes" sh.p.k. Kuçove do te jete 153.569.518 leke duke kaluar ne llogarine rezerva te tjera diferencen prej 352 leke per efekt te rumbullakimit te pjeseve.

Ne kushtet kur vlera nominale e nje pjese eshte 1.000 leke, numri i pjeseve qe do ti shtohen Shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes" sh.p.k. Kuçove do te jete 153.569 pjese.

Pas sanksionimit juridik te zmadhimit kapitali i Shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes" sh.p.k. Kuçove do te ndryshoje si vijon:

- **Kapitali i nenshkruar nga 264.561.482 leke do te shtohet me 153.569.518 leke duke shkuar ne 418.131.000 leke.**
- **Numri i pjeseve nga 264.561 pjese do te zmadhohet me 153.570 pjese duke arritur ne 418.131 pjese.**

[Signature]

Pas ketij ndryshimi kapitali dhe pjeset do te zoterohen 100 % nga shteti shqiptar.

Bashkangitjur ketij Raporti eshte Bilanci i ushtrimit 2008 te shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes" sh.p.k. Kuçove me ndryshimet perkatese pas operacionit .

Ekspert Kontabel i Autorizuar
Aida Maloku
Kuçove, me 15.10.2009

[Signature]
EKSPERTI KONTABEL
I AUTORIZUAR
AIDA MALOKU

Shoqeria " Uzina Mekanike e Naftes" shpk Kuçove

Bilanci Kontabel i dates 31.12.2008 me ndryshimet perkatese te zmadhimit

AKTIVET	Shenime	Ne leke	
		Para zmadhimit	Pas zmadhimit
I Aktivet afatshkurtra			
1 Aktivet monetare			
(i) Derivative dhe aktive te mbajtura per tregt.		2,595,279	2,595,279
(ii) - Derivatet			
(iii) - Aktivet e mbajtura per tregtim			
Totali 2			
3 Aktivet te tjera financiare afatshkurtra			
(i) Llogari/Kerkesa te arketueshme			
(ii) Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme	13(i)	97,148,100	97,148,100
(iii) Instrumenta te tjera borxhi	13(ii)	2,327,397	2,327,397
(iv) Investime te tjera financiare			
Totali 3		99,475,497	99,475,497
4 Inventari			
(i) Lendet e para			
(ii) Inventar i imet	4(i)	71,302,355	71,302,355
(iii) Prodhim ne proces	4(ii)	7,877,807	7,877,807
(iv) Mallra per shitje	4(iii)	21,358,404	21,358,404
(v) Mallra per shitje	4(iv)	86,094,324	86,094,324
(vi) Parapagesat per furnizime			
Totali 4		186,632,890	186,632,890
5 Aktivet biologjike afatshkurtra			
6 Aktivet afatshkurtra te mbajtura per shitje			
7 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra			
Totali i Aktiveteve Afatshkurtra (I)		288,703,666	288,703,666
II Aktivet afatgjata			
1 Investimet financiare afatgjata			
(i) Pjesmarrje te tjera ne njesi te kontrolluara			
(ii) Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje			
(iii) Aksione dhe letra te tjera me vlerë			
(iv) Llogari/Kerkesa te arketueshme afatgjata			
Totali 1			
2 Aktivet afatgjata materiale			
(i) Toka			
(ii) Ndetesa	112(i)	87,290,790	240,860,660
(iii) Makineri dhe pajisje	112(ii)	21,617,972	21,617,972
(iv) Aktivet te tjera afatgjata materiale (me vl kontab.)	112(iii)	37,171,559	37,171,559
Totali 2	112(iv)	583,827	583,827
3 Aktivet biologjike afatgjata			
4 Aktivet afatgjata jomateriale			
(i) Emri i mire			
(ii) Shpenzimet e zhvillimit			
(iii) Aktivet te tjera afatgjata jomateriale			
Totali 4			
5 Kapitali aksionar i papaguar			
6 Aktivet te tjera afatgjata			
Totali i Aktiveteve Afatgjata (II)		146,664,148	300,234,018
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		435,367,814	588,937,684

[Signature]
Ing. FATOS DARDHA

Shoqeria " Uzina Mekanike e Naftes" shpk Kuçove

Bilanci Kontabel i dates 31.12.2008 me ndryshimet perkatese te zmadhimit

DETYRIMET DHE KAPITALI	Shenime	Ne leke	
		Para zmadhimit	Pas zmadhimit
I Detyrimet afatshkurtra			
1 Derivatet			
2 Huamarrjet			
(i) Huat dhe obligacionet afatshkurtra			
(ii) Kthimet/Ripagesat e huave afatgjata			
(iii) Bono te konvertueshme			
Totali 2			
3 Huat dhe parapagimet			
(i) Te pagueshme ndaj furnitoreve			
(ii) Te pagueshme ndaj punonjeseve	13(i)	112,740,927	112,740,927
(iii) Detyrime tatimore	13(ii)	3,437,079	3,437,079
(iv) Hua te tjera	13(iii)	25,904,575	25,904,575
(v) Parapagimet e arketuara	13(iv)	2,180,052	2,180,052
Totali 3		144,262,633	144,262,633
4 Grantet dhe te ardhurat e shtyra			
5 Provizionet afatshkurtra			
Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)	5	336,600	336,600
II Detyrime afatgjata			
1 Huat afatgjata			
(i) Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare			
(ii) Bonot e konvertueshme			
Totali 1			
2 Huamarrje te tjera afatgjata			
3 Provizionet afatgjata			
4 Grantet dhe te ardhurat e shtyra	3	172,415	172,415
Totali i detyrimeve afatgjata (II)	4	584,912	584,912
Totali i detyrimeve		757,327	757,327
TOTALI I DEYRIMEVE (I + II)		145,356,560	145,356,560
III KAPITALI			
1 Aksionet e pakices (perdoret vetem ne pasqyrat financiare te konsoliduara)			
2 Kapitali qe i perket aksionereve te shoqerise me me (perdoret vetem ne PF te konsoliduara)			
3 Kapitali aksionar			
4 Primi i aksionit	1113	264,561,482	418,131,000
5 Njesite ose aksionet e thesant (negative)			
6 Rezerva statusore			
7 Rezerva ligjore			
8 Rezerva te tjera	1117	1,462,536	1,462,536
9 Fitimet e pashperndara	1118	16,692,106	16,692,458
10 Fitimi (Humbja) e vitit financiar			
Totali i Kapitalit (III)	1110	7,295,130	7,295,130
TOTALI I DEYRIMEVE E KAPITALIT (I, II, III)		435,367,814	588,937,684

[Signature]
Ing. FATOS DARDHA